



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

RELACION

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË APLIKANTËVE (BANORË TË BASHKISË KORÇË)
NË VIJIM TË PROGRAMIT TË QEVERISË SHQIPTARE “PROGRAMI I KODIMIT”**

Bashkia Korçë prej vitesh në vizionin e saj ka transformimin e qytetit në një qytet teknologjik duke orientuar të rinjtë drejt trajnimeve dhe punësimit në tregun e teknologjisë dhe inovacionit.

Së fundmi Qeveria Shqiptare ka çelur Programin e Kodimit i njohur ndryshe edhe si Programi i Formimit Profesional i cili zbatohet nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Ky program ka në fokus rritjen e aftësisë profesionale, kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuësve me qëllim përgatitjen dhe integrimin më të shpejtë në tregun e punës në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Zhvillimi i teknologjisë, inovacioni, globalizimi, tregu i punës që transformohet çdo ditë, kërkon profesione të reja. Që të rinjtë t'i shfrytëzojnë këto mundësi të ofruara në këtë kohë, duhet të pajisen me disa aftësi të reja, aftësitë e shekullit 21, që janë logjika, kreativiteti, mendimi kritik, aftësitë praktike. Kurset profesionale kanë një kohëzgjatje nga 3 deri në 12 muaj.

Për këto kurse të formimit profesional Qeveria Shqiptare ofron dy lloje subvencionesh si më poshte:

· ***Deri në 100%:***

Për punëkërkuësit e papunë të regjistruar, të cilët do të ndjekin një kurs profesional.

· ***Deri në 50%:***

Për punëkërkuësit e tjerë të regjistruar, të cilët do të ndjekin një kurs profesional.

Janë përzgjedhur katër akademi (Holberton School Albania-Vela Group, SDA Albania by Protik/Qendra Protik , Albania ICT Academy/Make with ICT, dhe Betaplan Coding Bootcamps/Trifolium) të cilat do të ofrojnë këto kurse profesionale si Java, Javascript, Python, Web-development etj. Secila nga këto kurse ka kohëzgjatjen, frekuencën si dhe pagesën e ndryshme bazuar në kurrikula që ofron akademia. Aplikantët e interesuar regjistrohen tek zyra e punës për të përfitur nga skema mbështetëse që ofron ky program dhe aplikojnë përmes e-albania për të ndjekur kurset e formimit profesional. Aplikantët quhen fitues në momentin që kanë kaluar me sukses testin logjik/praktik ose teknik në përputhje me programin e kursit që ndjek.

Bashkia Korçë në kuadër të programit të inovacionit me qëllim frenimin e largimit të të rinjve dhe krijimin e mundësive të punësimit të tyre në Korçë, do të mbështesë të gjithë ata aplikantë, të cilët janë përzgjedhur si fitues nga akademitë përkatëse dhe plotësojnë këto kritere:

- Janë punëkërkuar që përfitojnë 50% nga mbështetja e qeverisë
- Janë banorë të Bashkisë Korçës
- Paga e tyre mujore nuk e kalon nivelin e pagës mesatare, sipas publikimit të fundit të INSTAT në datën e miratimit të këtij projekt-vendimi. (*paga mesatare 59,242 lekë*)

Masa e mbështetjes për këta aplikantë nga Bashkia Korçë do të jetë:

- Deri në 50% të vlerës që mbështet qeveria, në rastet kur akademitë nuk kanë donator tjetër
- Në rastin kur akademitë kanë donatorë të tjerë, Bashkia do të mbulojë diferencën e mbetur nga mbështetja e donatorëve dhe deri sa të plotësohet masa 50% e mbështetjes së ofruar nga qeveria.
- Në rastin kur akademitë ka lidhur marrëveshje me donator të tjerë, të cilët mbështesin mbi 50 % të mbështetjes së qeverisë, Bashkia Korçë nuk mbështet financiarisht.
- Mbështetja do të bëhet për 45 aplikantë, të cilët do të ndjekin këto kurse profesionale. Ky numër është bazuar mbi interesin e shprehur deri tani nga punëkërkuarët e Bashkisë Korçë dhe kapacitetet që akademitë kanë për të zhvilluar trajnimet fizikisht në Korçë.

Kostoja financiare e këtij programi kap vlerën **1,656,000 Lekë** sipas tabelës më poshtë:

/lekë

Akademia	Kursi profesional	Vlera e kursit	Nr i përfituesve	Mbështetja nga Bashkia Korçë	Vlera totale e mbështetjes
SDA Albania by Protik/Qendra Protik (ka donator)	Java	230,400	15	8,400	126,000
Betaplan Coding Bootcamps/Trifolium	Python Fullstack	264,000	15	66,000	990,000
Albania ICT Academy/Make with ICT	Web development/Cyber security	120,000	15	36,000	540,000
Total					1,656,000

Kjo mbështetje financiare do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2023 në programin AG122 dhe produktin V912AAI (projektet e Inovacionit), të cilat menaxhohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes me këtë strukturë buxhetore:

Duke iu referuar nenit 8 pika 1 dhe nenit 54 i ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve dhe VKM 646 datë 05.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional, nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurimit, për kurset e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”, i propozojmë këshillit të Bashkisë të miratojë mbështjen financiare të të rinjve të Bashkisë Korçë në vlerën 1 656 000 lekë sipas përcaktimeve të mësipërme.

SEKTORI I TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT

Megi DURO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS
BUXHETIT MENAXHIMIT
FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Valbona ZIKO

DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE MENAXHIMIT
TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO**



REPUBLIKA SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ date _____ . _____ . 2023

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË APLIKANTËVE (BANORË TË BASHKISË KORÇË)
NË VIJIM TË PROGRAMIT TË QEVERISË SHQIPTARE “PROGRAMI I KODIMIT”**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit si dhe bazuar në nenin 8 pika 1 dhe nenin 54 i ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjin nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve dhe VKM 646 datë 05.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional, nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurimit, për kurset e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”

VENDOSI

1. Të miratojë mbështjen financiare të aplikantëve (banorë të Bashkisë Korçë) në vijim të programit të Qeverisë Shqiptare “ Programi i Kodimit” në vlerën 1 656 000 lekë.
2. Masa e mbështetjes nga Bashkia Korçë do të jetë si më poshtë:
 - Deri në 50% të vlerës që mbështet qeveria, në rastet kur akademitë nuk kanë donator tjetër
 - Në rastin kur akademitë kanë donatorë të tjerë, Bashkia do të mbulojë diferencën e mbetur nga mbështetja e donatorëve dhe deri sa të plotësohet masa 50% e mbështetjes së ofruar nga qeveria.

- Në rastin kur akademia ka lidhur marrëveshje me donator të tjerë, të cilët mbështesin mbi 50 % të mbështetjes së qeverisë, Bashkia Korçë nuk mbështet financiarisht.
3. Mbështetja do të bëhet për 45 aplikantë, të cilët do të ndjekin këto kurse profesionale. Ky numër është bazuar mbi interesin e shprehur deri tani nga punëkërkuessit e Bashkisë Korçë dhe kapacitetet që akademitë kanë për të zhvilluar trajnimet fizikisht në Korçë si më poshtë

/lekë

Akademia	Kursi profesional	Vlera e kursit	Nr i përfi- tues ve	Mbështetja nga Bashkia Korçë	Vlera totale e mbështetjes
SDA Albania by Protik/Qendra Protik (ka donator)	Java	230,400	15	8,400	126,000
Betaplan Coding Bootcamps/Trifolium	Python Fullstack	264,000	15	66,000	990,000
Albania ICT Academy/Make with ICT	Web developmen t/Cyber security	120,000	15	36,000	540,000
Total					1,656,000

4. Aplikantet që përfitojnë duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë
- Janë punëkërkuess që përfitojnë 50% nga mbështetja e qeverisë
 - Janë banorë të Bashkisë Korçës
 - Paga e tyre mujore nuk e kalon nivelin e pagës mestatare, sipas publikimit të fundit të INSTAT në datën e miratimit të këtij projekt-vendimi. (*paga mesatare 59,242 lekë*)
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Ndërmarrja e shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R
Erion NEXHIPI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____